

L I G J
Nr.8504, datë 30.6.1999

**PËR PËRDORIMIN E PËRKOHSHËM TË TOKËS BUJQËSORE SHTETËRORE PËR
NDËRTIMIN E KAMPINGJEVE PËR STREHIMIN E POPULLATËS SË DËBUAR
FORCËRISHT NGA KOSOVA**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është të mundësojë vënien në dispozicion për përdorim të përkohshëm të tokës bujqësore shtetërore për ndërtimin e kampingjeve për strehimin e popullatës së dëbuar nga Kosova.

Neni 2

Lejohet ndërtimi i kampingjeve të përkohshme për strehimin e popullsisë së dëbuar forcërisht nga Kosova në tokat bujqësore shtetërore, që janë objekt i ligjit nr.8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore, pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”.

Neni 3

Procedurat e caktimit dhe miratimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore shtetërore për ndërtimin e kampingjeve të përkohshme dhe të rehabilitimit të saj pas mbylljes së kampingjeve, përcaktohen me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky ligji i shtrin efektet e tij nga data 24.3.1999 e në vazhdim.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2410 datë 14.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

